



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA			
Pranuar me dt. 17.12.2020			
Org. / U. / Jed.	Numer / Number / Broj	S. / lista / Appendix / Priloz	Vlera / Amount / Vlerat
	01-052-36456		120

RAPORT I PUNËS SË
KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
PËR VITIN 2020

Parimi kryesorë i KKSBS-së gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë në bashkëpunim me policinë dhe qytetaret, si dhe me forumet, organizatat tjera të sigurisë, KLSB-të, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhën me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

KKSBS-ja ka pasur si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Klinës.

Mbledhja e parë e cila ishte e paraparë të mbahet me datë 17.03.2020, nuk është mbajtur për shkak se munguan anëtarët e Këshillit, kjo për shkak të pandemisë dhe karantinimit të qytetit të Klinës.

Mbledhja e dytë:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Siguria në Komunën e Klinës,
4. Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 në Komunën e Klinës, gjendja aktuale.

Mbledhja e thirrur me datë 19.06.2020, është kryesuar nga Kryetari i Komunës z. Zenun Elezaj, "Ne kemi qenë komuna e parë që jemi prekur nga virusi Covid-19, ai rast ka ndikuar që të mobilizohemi të gjithë dhe ne morëm përgjegjësit për ta luftuar pandeminë. Unë falënderoj të gjitha institucionet, në radhë të parë drejtorinë e shëndetësisë, policinë, zjarrfikësit, punëtorët e kompanisë ambienti vërtet kanë qenë të pa lodhshëm. Gjithashtu, qytetarët gëzojnë një respekt të veçantë, sepse ata kanë ndikuar që ne sot jemi para një situatë tjetër. Klina ka pasur pesë raste deri me tani të prekur me virusin Covid-19, prej tyre katër nuk kanë pasur aktivitete në Komunën

e Klinës, një rast ka qenë shtetasja Italiane e cila ka punuar në Caritas, një rast ka ardhur nga karantina, dy raste kanë qenë punëtor që kanë punuar në sektorin e shëndetësisë në Prishtinë dhe vetëm një rast ka qenë në Komunën e Klinës një banore nga fshati Bokshiq ku edhe është menaxhuar shkëlqyeshëm, po ashtu kemi ndihmuar familjen në fjalë me gjëra që kanë pasur nevojë. Tani unë kërkoj sensibilizim, sapo dolëm nga takimi i shtabit emergjent mbledhja u thirr pikërisht për arsye se kohen e fundit situata ka nisur serish të përkeqësohet. Ne në mbledhjen e shtabit emergjent morëm vendim që të gjithë ata të cilët kërkojnë shërbime të jenë të pajisur me maska, por edhe shërbimi, kemi mungesë të pajisjeve mbrojtëse si doreza dhe maska por tenderi është i hapur dhe shpresoj se shumë shpejt do të përfundojnë procedurat e tenderimit dhe do të furnizohemi me to.

Java parë e pandemisë me të vërtetë ka qenë javë e frikshme, kemi pasur shumë kërkesa për ndihma në atë kohë, tash kemi edhe dy pako ndihmëse të Komunës njëra është 50.000.00 € dhe tjetra në vlerë prej 90.000.00€ të gjitha këto janë të destinuara për situatën e paraqitur nga pandemia, do të pajisemi me mjete mbrojtëse për punonjës por edhe për pako ushqimore, pra janë të planifikuara të shpërndahen 1200 pako ushqimore për 700 pako veç ka nisur procedura e tenderimit e mandej edhe për 500 tjera. Është formuar një komision nga Kuvendi me përbërje nga anëtarët e kuvendit dhe ekzekutivit, ai komision ka përpiluar listën e gjithë atyre të cilët kanë nevojë për ndihmë.

Raporti nga Policia:

Komandanti i Policisë, z. Ragip Bytyqi: Theksoj, unë jam emëruar komandant i policisë në Stacionin Policor në Klinë nga, data 9 mars 2020. Duke marrë parasysh edhe statistikën e më hershme situata në Komunën e Klinës është e qetë. Nga fillimi i vitit e deri me sot në stacionin policor janë paraqitur 202 raste, incidente penale, nga këto 23 janë aksidente komunikacioni, fatkeqësisht një aksident me fatalitet kemi pasur muajin e kaluar në fshatin Gremnik”. Gjithashtu theksoj se janë shqiptuar 2230 gjopa kundërvajtje të ndryshme, janë arrestuar 176 persona, janë konfiskuar 13 armë të llojeve të ndryshme, gjithashtu janë konfiskuar edhe 103 copë municion i kalibrave të ndryshëm, pohoi komandanti Bytyqi, duke theksuar po ashtu se për momentin po vazhdojmë

me disa plane operative, po i zbatojmë disa rekomandime nga drejtoria rajonale e policisë. “Po ashtu, ka vazhduar Komandanti, gjatë kohës së pandemisë jemi asistuar edhe nga disa zyrtarë policor që janë nga komuna e Klinës por që punojnë në vende tjera, nga data 6 të gjithë ata zyrtarë tashmë janë kthyer në vendin e tyre të punës ku kanë punuar më herët, tani ne po punojmë me orare të rregullt.

Mbledhja e tretë:

Rendi i Ditës:

1. Arsyetimi i mungesave

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar

3. Siguria në Komunën e Klinës

4. Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 në Komunën e Klinës, gjendja aktuale

5. Të ndryshme

Mbledhjen e tret e mbajtur me datë 23.10.2020 e kryesoj zv. kryesuesi z. Besim Hoti i cili theksoj se Gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës në përgjithësi është e qetë. Kemi disa raste të infektimit me virus Covid-19 por fatmirësisht situata është nën kontroll kjo duke ju falënderuar në radhë të parë qytetareve dhe të gjitha institucioneve si shëndetësisë, Policisë së Kosovës etj.

Raporti i Policisë

Komandanti i Policisë, z. Ragip Bytyqi: Theksoj sa i përket çështjes së sigurisë në zonën tonë të sigurisë, lirisht mundë të themi se situatën e kemi shumë të qetë. Nuk kemi ndonjë incident i cili është i përmasave të mëdha i cili ja vlen të ceket, me aplikimin e ligjit anti Covid-19 Ne na ka ndihmuar shumë në realizimin e objektivave tona ditore. Unë para jush do ta prezantoj një raport 9-të mujorë të realizimit të objektivave, veprimeve policore dhe rezultatet tona. Pra deri me tani janë paraqitur 351 incidente penale nga këto incidente 302 raste janë të zbuluara, nëse e marrim në përqindje i bie që rastet e zbuluara janë 82.2%, nga këto raste 101 raste janë vjedhje të rënda, 5 raste janë pengim i personit zyrtarë, 6 raste janë sulm ndaj personit zyrtarë, 4 raste janë lajmërimet të rrejshme, 22 raste janë armëmbajtje pa leje, 4 raste janë ndërtime pa leje sa i përket rasteve të ndërtimeve pa leje me parë nuk ka pasur raste të iniciuara sa i përket kësaj çështje, kodi i procedurës penale në vitin 2018 i ka autorizuar zyrtaret policorë që veprat penale ndërtimet pa leje ndjekin sipas detyrës zyrtare, që nga ardhja ime janë 4 raste të iniciuara ndërtime pa leje. Sipas informacionit që posedojmë, komuna është në prag të marrëveshjes me një kompani për rrënimin e ndërtimeve pa leje dhe në momentin që do të bëhet rrënimi i tyre kjo dukuri do të parandalohet. Ndërsa 5 raste janë mashtrime, 5 raste janë falsifikim i parasë, 9 raste janë posedim i paautorizuar i narkotikeve, 17 raste i kemi iniciuar për mosveprim sipas dispozitave ligjore në kohën e pandemisë, 18 raste janë dhunë në familje, 28 raste janë lëndime trupore ndërsa 2 raste janë lëndime të rënda trupore, 15 raste janë kanosje, tri raste janë tentim vrasje dhe 15 raste janë sulme fizike. Dihet se edhe në të kaluarën zonën e përgjegjësisë së Klinës e kanë përcjellë në përgjithësi dhe në këtë periudhë nëntë mujore fatkeqësisht një aksident e kemi pasur me fatalitet, 3 aksidente me lëndime, 48 aksidente me dëme materiale, kjo statistikë nuk është krejt e saktë për shkakë që në magjistrale ka aksidente e me të cilat merret trafiku rajonal. Në këtë nëntë mujor i kemi realizuar 55 asistime duke përfshirë ato të gjykatave, prokurorive dhe përmbaruesve.

Janë realizuar 1768 patrullime me veturë, 668 patrullime këmbë, janë formuar 2414 pika kontrolli, në këtë periudhë janë konfiskuar 20 armë, janë arrestuar gjithsej 315 persona, ndërsa nëntë mujorin e par të këtij viti janë shqiptuar 5526 gjoba ku nga këto gjoba janë gjithsej 129358€ janë inkasuar në komunë. Nga të gjitha këto incidente fatmirësisht nuk kemi pasur asnjë incident të rëndë. Unë gjithashtu shfrytëzoj rastin ti falënderoj të gjithë qytetaret të cilët kanë respektuar maksimalisht masat të cilat janë ndërmarrë nga qeveria, Ne si komunë mund të

krenohemi sa i përket rasteve të infektuar kjo fal bashkëpunimit mes policisë, shëndetësisë dhe qytetareve. Ndërsa sa i përket disa pyetjeve nga mbledhja e kaluar duke u bazuar në procesverbalin e mbledhjes, në nëntë mujorin e këtij viti, 15 raste kanë qenë incidente ku kanë qenë të përfshirë viktimat nga nacionaliteti serb, mirëpo nuk do të thotë se këto viktimat vetëm që kanë qenë serbë janë atakuar sepse hajdutet nuk zgjedhin a është serbë apo shqiptarë. Nga këto 15 raste 5 raste janë ngritur kallxime penale dhe kanë shkuar në prokurori, dy raste janë mbyllur me raporte të veçanta sepse nuk ka pasur elemente të veprës penale, dy raste kanë shkuar me kallxim penal kundër dy personave të panjohur që akoma Ne nuk kemi mundur mi zgjedhë, 1 rast i është dorëzuar njësisë rajonale dhe 5 raste akoma janë nën hetime.

-Takimet e KKSBB-ë janë kryesuar nga kryetari i komunës z. Zenun Elezaj dhe nënkryetari i komunës së Klinës z. Besim Hoti.

Rezultatet e arritura nga takimet e KKSBB-së për vitin raportues 2020

-Institucionet komunale janë marrë më shumë me ndriçimin, në disa pjesë të qytetit janë ndërmarr masa nga drejtoria përkatëse për rregullimin e ndriçimit.

-Heqjen e disa shenjave të komunikacionit aty ku kanë qenë të vendosura gabim, vendosjen e shenjave adekuate.

-Masa të ndërmarra nga policia e Kosovës dhe Inspektoret, ndaj të gjithë atyre të cilët kanë rrezikuar sigurinë publike me zjarr vëniet.

-Shtimi i kamerave në disa shkolla dhe disa pjesë të qytetit.

-Marrja e masave të duhura parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit

Gjatë vitit 2020 janë mbajtur dy takime të rregullta ndërsa një takim i cili ishte i paraparë të mbahet, nuk është mbajtur për shkak se ka munguar kuorumi, për shkak të pandemisë nuk është arritur të mbahen të gjitha mbledhjet e rregullta të KKSBB-së, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtareve dhe pjesëmarrësve të cilët kanë qenë të ftuar në takime.

